Vendimi i PSSP-së për ankesën e znj. Svetllana Joçiq (Nr. 34/09)

Pas shqyrtimit të mendimit dhe rekomandimeve të Panelit tim këshillëdhënës për të drejta të njeriut lidhur me ankesën e znj. Svetllana Joçiq (lënda nr. 34/09), më datën 5 gusht 2013 kam njoftuar Panelin tim këshillëdhënës për si në vijim:

- Që në fillim dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për punën e Panelit dhe për rekomandimet e dhëna lidhur me ankesën në fjalë.

- Lidhur me rekomandimin e parë, ashtu siç është rekomanduar nga Paneli, UNMIK-u do të vazhdojë të nxisë EULEX-in dhe autoritetet e tjera kompetente që të vazhdojnë së ndërmarri të gjithë hapat e mundshëm për tu siguruar që hetimet penale lidhur me zhdukjen dhe vrasjen e djalit të ankueses të vazhdohen dhe që kryerësit e krimeve të vihen para drejtësisë.

- Lidhur me rekomandimin e dytë të Panelit, më vjen keq për mungesën e hetimit të efektshëm lidhur me kidnapimin dhe vrasjen e mundshme të djalit të ankueses, gjë e cila gjithashtu ka shkaktuar shqetësim dhe dhimbje shpirtërore.

- Paneli gjithashtu ka rekomanduar që unë të ndërmarr hapa të duhur lidhur me pagesën e kompensimit të duhur për ankuesen lidhur me dëmin moral, si dhe të ndërmarrë hapa të duhur për realizmin e programit të plotë dhe gjithëpërfshirës të reparacioneve. Në këtë drejtim, dëshiroj të përkujtoj se veprimet në fjalë kanë të bëjnë me aktivitetet e institucioneve të themeluara në kuadër të administratës së përkohshme të Kosovës. Si të tilla, po qe se UNMIK-u edhe sot do të vazhdonte të ketë kontroll ndaj këtyre institucioneve, do të kishte qenë në pozitë që t'ia referojë rekomandimet e Panelit këtyre institucioneve në mënyrë që ato të ndërmarrin veprimet e duhura. Unë jam i gatshëm të diskutoj mundësinë e themelimit të mekanizmit për trajtimin e këtyre çështjeve me autoritetet relevante në rrethana duhura.

- Në fund, përkitazi me rekomandimin e pestë lidhur me garancitë për mospërsëritje, dëshiroj të theksoj se UNMIK-u më nuk zbaton funksione policore, duke përfshirë edhe hetimet policore. Në këtë drejtim, dëshiron të përkujtoj se Paneli është themeluar nga UNMIK-u me mandat për të shqyrtuar ankesat nga cilido person a grup i individëve që pretendojnë se kanë qenë viktimë e shkeljeve të të drejtave të tyre të njeriut nga ana e UNMIK-ut. Unë gjithashtu dëshiroj të përkujtojë se mandati i UNMIK-ut dhe, rrjedhimisht, mandati i PSSP-së, është i kufizuar në atë që parashihet në Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, ashtu siç ka ndryshuar me kalimin e kohës sipas rrethanave të përcaktuara nga Këshilli i Sigurimit.

- Thënë në përgjithësi, Panelin mund ta informojmë se organet kryesore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kanë miratuar rezoluta dhe vendime të shumta, përmes të cilave pasqyrohet rëndësia e avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe mbrojtjen e tyre nga Kombet Bashkuara. Organizata gjithashtu vazhdon të bëjë ndryshime me qëllim të fuqizimit të punës së saj për të ardhmen dhe brenda fushëveprimit të Organizatës Kombeve të Bashkuara, ku mund të bëjë ndryshime. Në këtë aspekt, do të vazhdojë përpjekjet e veta në plotësimin e misionit të saj të mbrojtjes së njerëzve nga e keqja.”

/*nënshkrimi*/

Farid Zarif
Përfaqësues special i sekretarit të përgjithshëm